

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 20.9.2019**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME HIMARË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 20.9.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a.’”,

**VËREN SE:**

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Himarë (UK Himarë), me shkresën nr. 334 prot., datë 28.8.2019 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Himarë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Himarë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 20 852 banorë të Bashkisë Himarë, si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime nga shoqëria UK Himarë

| Nr.           | Njësitë administrative të Bashkisë Himarë | Popullsia në juridiksion | Popullsia e shërbyer |
|---------------|-------------------------------------------|--------------------------|----------------------|
| 1             | Himarë                                    | 13 488                   | 12 089               |
| 2             | Lukovë                                    | 9 477                    | 8 763                |
| 3             | Horë-Vranisht                             | 3 697                    | 0                    |
| <b>TOTALI</b> |                                           | <b>26 662 banorë</b>     | <b>20 852 banorë</b> |

Shënim. UK Himarë nuk ofron shërbim në Njësinë Administrative Horë-Vranisht.

b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Fajola Duro, zotëron diplomë master në “Inxhinieri mjedisi”, profili “Trajtim uji”, datë 7.12.2018.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Himarë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

a) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

c) ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Himarë rekomandon:

- Shoqëria UK Himarë duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në të gjithë Bashkinë Himarë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Himarë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a., me NUIS L26328203D, në kategoritë:

- a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) drejtues ligjor – Andrea Goro;
- b) drejtuese teknike – Fabjola Çaushaj (Duro).

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a. është:

Bashkia Himarë: njësitë administrative: Himarë;  
Lukovë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a., për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**